Puna sociale në shkollë e komunitetit të shkollës elementare Amriswil-Hefenhofen-Sommeri

Puna sociale në shkollë (PSSH) ofron ndihmë gjatë vështirësive në fushën shkollore dhe jashtë shkollës. Kështu ajo shoqëron dhe mbështet nxënësët dhe nxënësit të të gjitha moshave gjatë problemeve sociale dhe sfidave personale.

Për shembull fëmijët dhe të rinjtë vijnë në PSSH, për shkak se ato janë fyer shpesh nga bashkëshkollarët dhe nuk kanë më besim që të thonë diçka në mësim. Prindërit i drejtohen PSSH-së, për shkak se ato e shohin fëmijën e tyre në rrezik, nga që me celularin chaton me të huajt pa vrarë mendjen dhe dërgon foto të tij. Mësimdhënësit perceptojnë, nëse një nxënëse ose nxënës në klasën e tyre margjinalizohet dhe ka nevojë për mbështetje nga PSSH-ja.

Pra, puna sociale në shkollë këshillon jo vetëm të rinjtë dhe nxënësit. Edhe prindërit dhe mësimdhënësit mund të përfitojnë nga oferta. Sipas nevojës ne angazhojmë edhe përkthyes/përkthyese.
Bisedat në punën sociale në shkollë janë me vullnet të lirë dhe pa pagesë. Përveç kësaj puna sociale në shkollë i nënshtrohet detyrimit të heshtjes; kjo nënkupton që përmbajtja e bisedës trajtohet me koinfidencë.

Forma e punës së punës sociale në shkollë është e shumëllojshme. Një pjesë e madhe e punës përbëhet nga bisedat e veçanta me nxënësët dhe nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit. Puna sociale në shkollë punon edhe me të gjithë klasën ose grupet.

Një pjesë tjetër e rëndësishme është puna preventive. Puna sociale në shkollë e komunitetit të shkollës elementare të Amriswil-Hefenhofen-Sommeri ofron edhe 30 të ashtuquajtura module të ndryshme preventive për temat të ndryshme. Modulet preventive janë oferta të veçanta të arsimimit, të cilat prenotohen nga mësimdhënësit dhe realizohen në klasë nga PSSH.

Shembujt janë:

- Fotografi, video, s, Videos, Cybermobbing
  Nxënësët dhe nxënësit mësojnë nocionet bazë për përdorim të përgjegjshëm të fotografive dhe të dhënave.

- Ne jemi një ekip
  Te ky modul klasa mëson parakushtet për një shpirt të mirë të ekipit.

- Mobbing
  Në bazë të shembujve bëhen të dukshme dhe përpunohen proceset e mobbing-ut.

  Puna sociale në shkollë mbështet zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjëve në rrugën e tyre për një jetë të pavarur.

Në fletëpalosjen tonë (shih shtyllën djathtas) do t'i gjeni të dhënat tona për kontakt. Përveç kësaj Ju mund të shikoni tekstin aktual informativ në gjuhë të ndryshme.